



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETESE  
DREJTORIA E PROKURIMEVE ADMINISTRATIVE DHE SHËRBIMEVE

Formulari nr. 3

[Datë 19.08.2024]

**FTESË PËR OFERTË**

**Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri Bashkia Tiranë  
Adresa Sheshi “Skenderbej”, Tiranë  
Tel/Fax 0035542256799  
E-mail administrative.prokurime@tirana.al  
Adresa e Internetit [www.tirana.al](http://www.tirana.al)

Autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë do të zhvillojë procedurën e prokurimit për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar me objekt: **“Blerje 2 (dy) bileta udhëtimi vajtje-ardhje”**.

Data e zhvillimit do të jetë **19.08.2024 ora 17.30** në adresën [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna (kërkesat specifike të objektit të prokurimit):

**1. “Blerje 1 (një) biletë udhëtimi vajtje-ardhje Tiranë- Zagreb-Split, Kroaci- Varshavë, Poloni- Alpach, Austri -Tiranë”, si më poshtë:**

- Nisja nga Tirana drejt Zagreb, do të bëhet në datën 20.08.2024 në orën 12:05, mbërritja në Zagreb në orën 18:05 (me një ndalesë);
- Nisja nga Zagreb drejt Split, do të bëhet në datën 22.08.2024 në orën 14:40, mbërritja në Split në orën 15:30 (pa ndalesë);
- Nisja nga Split drejt Varshavës, do të bëhet në datën 23.08.2024 në orën 17:30, mbërritja në Varshavë në orën 20:40 (me një ndalesë);
- Nisja nga Varshava drejt Alpach, do të bëhet në datën 24.08.2024 në orën 17:10, mbërritja në Alpach në orën 23:55 (me një ndalesë);

- Kthimi nga Alpach drejt Tiranës do të bëhet në datën 26.08.2024, në orën 08:25, mbërritja në Tiranë në orën 14:15 (me një ndalesë).

## 2. “Blerje 1 (një) biletë udhëtimi vajtje-ardhje Tiranë- Varshavë, Poloni- Alpach, Austri - Tiranë”, si më poshtë:

- Nisja nga Tirana drejt Varshavës, do të bëhet në datën 23.08.2024 në orën 13:30, mbërritja në Varshavë në orën 15:40 (pa ndalesë);
- Nisja nga Varshava drejt Alpach, do të bëhet në datën 24.08.2024 në orën 17:10, mbërritja në Alpach në orën 23:55 (me një ndalesë);
- Kthimi nga Alpach drejt Tiranës do të bëhet në datën 26.08.2024, në orën 08:25, mbërritja në Tiranë në orën 14:15.

Me një ndalesë, bagazhe të përfshira.

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë:

### a) *Rezervimin e biletës sipas destinacionit të kërkuar.*

*\*Operatori ekonomik së bashku me itinerarin e ofruar, duhet të paraqesë edhe të dhënat e kontaktit (numër telefoni, e-mail) në sistem. Nëse itinerari i ofruar nga OE është në përputhje me kërkesat e AK dhe sipas destinacionit të kërkuar, Autoriteti Kontraktor pas konfirmimit do të nis të dhënat e personave udhëtues në adresën elektronike (email) të Operatorit ekonomik.*

Operatori ekonomik duhet të ketë të përfshirë në fushën e veprimtarisë së tij në QKR, objektin e prokurimit.

Me marrjen e njoftimit, ofertuesi i renditur në vend të parë duhet t'i përgjigjet Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë për realizimin apo pamundësinë e realizimit të objektit të prokurimit, brenda 2 (dy) orëve nga momenti i njoftimit të operatorit nga Komisioni i sistemit dinamik të biletave. Në rast të pamundësisë së realizimit të objektit të prokurimit duhet të jepen arsyet që kanë shkaktuar pamundësinë e realizimit të objektit.

Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të dorëzojë biletën elektronike elektronikisht (email: [administrative.prokurime@tirana.al](mailto:administrative.prokurime@tirana.al)) brenda 2 (dy) orëve nga momenti i shpalljes së fituesit.

Në rast se ofertuesi i shpallur fitues tërhiqet nga oferta e tij, nuk paraqitet në afatin kohor, ose nuk plotëson kërkesat e përcaktuara nga Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë në “Ftesën për ofertë” do të përzgjidhet ofertuesi i renditur i dyti në listën e ofertave dhe kështu me rradhë, deri në ofertuesin e renditur e fundit të mbetur në klasifikim.

Afati i dorëzimit të dokumentave: Brenda 2 (dy) orëve nga momenti i shpalljes së fituesit.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit në sistem.